



Procesi i vaksinimit në Kosovë dhe mbrojtja nga varianti Delta

Qëllimi

Që nga paraqitja për herë të parë e covid-19 e deri më tani, janë regjistruar variante të ndryshme të këtij virusi. Varianti Delta, i shfaqur për herë të parë në Indi përhapet më shumë mes njerëzve në krahasim me variantet e tjera.¹ Për këtë arsye është e rëndësishme analizimi i përhapjes së këtij varianti dhe, politikat që duhet ndjekur Kosova për motivimin e qytetarëve për vaksinim.

Qëllimi i këtij punimi të shkurtër është krahasimi i numrit të rasteve me variantin Delta, në vendet si Franca, Luksemburgu, Lituania, Mali i Zi, Serbia dhe Shqipëria dhe të analizohen politikat që i kanë ndërmarrë këto vende dhe të tjera, për të motivuar qytetarët që të imunizohen kundrejt COVID-19. Rekomandimet e dala nga ky punim do t'i adresohen Ministrisë së Shëndetësisë, Institutit Kombëtarë të Shëndetësisë Publike dhe Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Kuvendit të Kosovës.

¹ Qendra për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve “Çfarë duhet të dini rreth varianteve”. Mund të gjendet në <https://dpl.us/gl1>

Numri i rasteve të prekur me variantin Delta dhe numri i qytetarëve të vaksinuar në tetë vende të ndryshme

Vendi	Nr. i rasteve të përgjithshme me COVID-19 ²	Nr. i rasteve me variantin Delta ³	Nr. i dozave të administruara të vaksinës ⁴	Nr. i të vaksinuarave me një dozë ⁵	Nr. i të vaksinuarave me dy doza ⁶
Franca	6,440,082	6,442	78,74 m	45,23 m	34, 44 m
Luksemburgu	74,545	780	738,057	397,995	340,062
Lituania	288, 173	209	2,86 m	1,53 m	1,33 m
Serbia	729,150	5	5,61 m	2,87 m	2,74 m
Shqipëria	134, 761	11	720,232	720,232	560,00
Maqedonia Veriore	159,908	7	982,645	543,597	439,048
Mali i Zi	104, 613	Nuk ka të dhëna	351,202	191,020	160,182
Kosova	112, 653	Nuk ka të dhëna	504, 817	333,965	170, 852

Siç mund të shihet nga tabela, numri i personave të vaksinuar me dy doza, në krahasim me numrin e qytetarëve të Kosovës që duhet të vaksinohen, është ende i vogël. Kjo nuk është për shkak të mungesës së dozave të vaksinave pasi Ministria e Shëndetësisë ka siguruar doza të konsiderueshme të vaksinave, por për shkak të hezitimit të personave për t'u vaksinuar. Në këtë raport të shkurt janë dhënë rekomandime Ministrisë së Shëndetësisë për të ndërmarrë hapa për motivimin/nxitjen e qytetarëve që të vaksinohen.

² Universiteti John Hokins (JHU). Mund të gjendet në <https://dpl.us/ael> (Të dhënat e përditësuara më 8/7/2021).

³ Statista.com "Numri i rasteve me variantin Delta në botë, deri më 9 gusht 2021, sipas shtetit dhe territorit.

Mund të gjendet në <https://dpl.us/as8>

⁴ Our World in Data "Vaksinimi anti-covid". Mund të gjendet në <https://dpl.us/tev>

⁵ Po aty.

⁶ Po aty.

Mes politikave ndëshkuese dhe motivuese

Sipas ekspertëve shëndetësor mos vaksinimi i qytetarëve është faktor i varianteve të reja, si dhe ndikon që virusi COVID-19 të shumohet.⁷ Përveç sfidës së shpërndarjes së barabartë të vaksinave tek qytetarët, shqetësim mbetet hezitimi i qytetarëve për t'u imunizuar kundër këtij infeksioni. Ky hezitim mund të vie si pasojë e dyshimeve rreth efikasitetit të vaksinave, lajmeve të rreme, dhe pasigurisë rreth efekteve anësore që mund të ketë vakcina anti-COVID-19. Sipas portalit të lajmeve telegrafi.com në Kosovë, duke cituar një organizatën GeoPost e cila kryen kërkime mbi ndikimin e huaj në Ballkanin Perëndimor, Kosova është prekur nga fushata dezinformuese kundër vaksinimit të Rusisë. Për më tepër, themeluesit e grupit “[Stop Vaksinimit](#)” janë profile të rreme që provojnë që ta përçajin shoqërinë kosovare në raport me vaksinimin. Kohën e fundit, shumë studime shkencore kanë zbuluar me mijëra llogari ruse nëpër rrjetet sociale të cilat janë duke përhapur mesazhe kundër vaksinës.⁸

Mirëpo, për të ulur nivelin e pasigurisë, vende të ndryshme kanë ndërmarrë masat që e nxisin vaksinimin e qytetarëve.

Disa nga politikat që kanë ndërmarrë vendet për motivimin e qytetarëve për vaksinim janë:

- Në Francë, qytetarëve i duhet leja e veçantë për të hyrë në kafene, restaurante, qendra tregtare dhe udhëtimi me tren apo aeroplan. Për të marrë një leje të tillë, njerëzit duhet të vaksinohen plotësisht, të kenë test negativ ose të tregojnë se e kanë kaluar virusin.⁹
- Në Britani të Madhe, disa restaurante në bashkëpunim me qeverinë, po shpërndajnë pica falas dhe taksitë do të jenë pa pagesë për të rinjtë që janë vaksinuar, ose që zgjedhin të vaksinohen. Po ashtu firmat e shpërndarjes dhe transportit ofrojnë zbritje në çmim për shërbimet e tyre.¹⁰
- Italia e ka bërë të detyrueshme pasaportën shëndetësore për mësuesit. Qeveria ka njoftuar se mësuesit duhet të kenë dëshmi të vaksinimit kundër koronavirusit, para se të hyjnë në klasë. Një pasaportë e tillë është bërë e detyrueshme edhe për udhëtarët në trena, aeroplanë, si dhe nëpër dyqane.¹¹
- Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Presidenti Joe Biden i ka bërë thirrjeve shteteve që të ofrojnë nga 100 dollarë për të vaksinuarit kundër koronavirusit. Po ashtu Qeveria federale do të rimbursojë bizneset e vogla dhe ato të mesme, të cilat u ofrojnë punëtorëve ditë pushimi për t'u vaksinuar.¹²
- Sipas Organizatës Evropiane për Parandalimin e Sëmundjeve dhe Kontrollit, disa shtete të Evropës kanë vendosur qendra masive të vaksinimit në bashkëpunim me komunitat. Po ashtu kanë angazhuar ekipe mobile për vaksinim të qytetarëve që nuk mundën të kenë qasje në qendrën e vaksinimit.¹³

⁷ CNN “Personat e pavaksinuar janë “arsye për variante” thonë ekspertët e sëmundjeve infektive”.

Mund të gjendet në <https://dpl.us/gg9>

⁸ Telegrafi.com “Rusia me grupe propaganduese në rrjete sociale kundër vaksinimit edhe në Kosovë”.

Mund të gjendet në <https://dpl.us/ehq>

⁹ Koha.net “Franca përshpejton vaksinimin pas thirrjes së Macronit”. Mund të gjendet në <https://dpl.us/4zs>

¹⁰ CNN “Pica dhe taksitë përdoren si motivim për të shtyer të rinjtë në Britaninë e Madhe të vaksinohen kundër COVID-19”. Mund të gjendet në <https://dpl.us/l0x>

¹¹ Radio Evropa e Lirë “Italia e bën të detyrueshme pasaportën shëndetësore për mësuesit”.

Mund të gjendet në <https://dpl.us/93d>

¹² HuffPost “Biden u bën thirrje shteteve që të dhurojnë 100 dollarë për çdo të person të vaksinuar”.

Mund të gjendet në <https://dpl.us/b4a368>

¹³ Qendra Evropiane për Parandalimin e Sëmundjeve dhe Kontrollin “Sfidat dhe praktikat e mira”.

Mund të gjendet në <https://dpl.us/2fdadf>

Në Kosovë numri i rasteve aktive me COVID-19 është 1,903. Përkundër faktit që Kosova ka mjaftueshëm vaksina të siguruara, rreth 291,788 shqetësuese mbetet hezitimi i qytetarëve për imunizim kundër koronavirusit. Në disa komuna, p.sh. komuna e Mitrovicës, pavarësisht rezervimit të terminit përmes platformës online <"e-kosova">, qytetarët presin në grumbull para qendrës së vaksinimit 'Rexhep Mitrovica'. Kjo për arsye se qytetarët nuk e përcaktojnë orarin e terminit për vaksinim, dhe kështu paraqiten në qendër në orare të ndryshme. Gjithashtu, ka qytetarë të cilët janë të regjistruar në komuna të caktuara, por jetojnë në Prishtinë, dhe kur e caktojnë terminin në platformën <"e-kosova">, sistemi i cakton automatikisht qendrën e vaksinimit në komunën ku është regjistruar, dhe jo në komunën ku aplikuesi jeton aktualisht.

Disa nga rekomandimet që D+ i drejton Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit Kosovar për Shëndetësi Publike për nxitjen e qytetarëve për vaksinim janë

- Vendosja e qendrave për vaksinim në fshatra, pasi jo të gjithë qytetarët e kanë mundësinë të frekuentojnë qendrat kryesore të vaksinimit;
- Vendosja e shenjave në dysheme në qendrat e vaksinimit, në mënyrë që të zbatohet distanca fizike mes qytetarëve;
- Vaksinimi për mësuesit/et, punëtorët/et e marketeve, personeli në bizneset e hotelerisë, shoferëve/eve të autobusëve dhe taksive të bëhet i obliguar, kjo pasi këto janë kategoritë që kanë kontakte të drejtpërdrejta me qytetarët;
- Të formohen ekipe mobile për vaksinim në zonat më të thella dhe tek pacientët më të moshuar;
- Të organizohen debate publike dhe emisione televizive me ekspert shëndetësor për të shpjeguar efikasitetin e vaksinës, dhe të jetë të hapura për pyetje nga publiku;
- Të jepen mesazhe përmes videove nga personat që kanë ndikim në publik, të cilët janë imunizuar;
- Vaksinimi të vazhdojë edhe gjatë fundjavave, në mënyrë që të ofrohen më shumë mundësi për vaksinim nga qytetarët.

Deklaratë mohuese:

Ky publikim është botuar me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Demokraci Plus (D+) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian. Projekti “Kontribut në gjetjen e shkeljeve në prokurim publik të institucioneve në luftën kundër pandemisë COVID-19” i financuar nga BE, implementohet nga Demokraci Plus (D+).



**Funded by
the European Union**

